



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Kandidatët e interesuar, punonjës të kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativë, me kohë të plotë të UE-së, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme etj, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Senatit Akademik gjejnë informacionin e mëposhtëm:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ.

Pozicioni i punës: Drejtorit të Drejtorisë Juridike Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI

Drejtori i Drejtorisë Juridike Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës në këtë Drejtori duke koordinuar dhe bashkërenduar punën brenda drejtorisë si dhe strukturave të tjera përbërëse të UE-së brenda kuadrit të zbatimit të ligjit të arsimit të lartë në lidhje me veprimtarinë e punës në këtë Institucion; bën interpretimin juridik të çështjeve të ndryshme të UE-së; verifikon paraprakisht urdhrat dhe udhëzimet e Rektorit dhe Administratorit të UE-së; harton projekt marrëveshjet e bashkëpunimit të UE-së; bën përfaqësimin ligjor të UE-së në çështjet ku është palë UE-ja; përcakton objektivat për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj; orienton e monitoron veprimtarinë e personelit brenda drejtorisë në realizimin e detyrave të ALUMNI; përgjigjet për disiplinën në strukturën që drejton; raporton tek titullari, harton raporte, kryen analiza periodike dhe propozon zgjidhje në rastet kur është e nevojshme në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret e përgjithshme e të posaçme:

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhetë këtë zotësi të plotë për të vepruar.
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e argimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi
- të plotësojë kriteret e posaçme

Kritere të posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) ose ekuivalente me të në fushën juridike. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- Të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e kërkuar;
- Të ketë përvojë pune në pozicione drejtuese;
- Të ketë përvojë punë në IAL;
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm”; të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune (15 – 17.12.2025), nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al, dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (12.12.2025 – 31.12.2025). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.